



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1424/Prot.
2

Rrëshen me, 03 . 05 . 2024

V E N D I M

Nr. 34 datë 26. 04. 2024

**PËR
"PËRDORIM FOND MBROJTJE CIVILE", BASHKIA MIRDITË.**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", ligjin nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", në Udhëzimin nr.9, datë 20.07.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin Plotësues nr. 1, datë 24.01.2024 të ministrisë Ekonomisë dhe Financave, "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2024", në Vendimin nr. 50, datë 15.12.2023, të këshillit bashkiak Mirditë, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024", relacionin nr. 1424 prot, datë 09.04.2024, të drejtorisë planifikimit, zhvillimit të territorit dhe strehimit, së bashku me projekt-vendimin e kryetari i bashkisë, pas diskutimeve në mbledhjen e këshillit bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë përdorimin e fondit të mbrojtjes civile, vlerën **184 800** (njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind) lekë, për **bonus qiraje**;
 - ✦ Për familjen e Z. Lekë Zef BUNAJ, njësia administrative Rrëshen, banesa e të cilit është bërë e pabanueshme nga rrëshqitja e tokës (sipas relacionit të sektorit të emergjencave civile), për një periudhë 1 (një) vjeçare, Janar-Dhjetor 2024.
 - ✦ Përfitimi mujor, sipas relacionit të sektorit strehimit, **15 400** (pesëmbëdhjetë mijë e katërqind) lekë në muaj.
2. Pagesa të kalojë me bordero, në degën e Postës Mirditë, zyra Postare Rrëshen.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i bashkisë Mirditë, (drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe tatim taksat).

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICA KU